

URDHËR
Nr. 530, datë 18.9.2023

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 14, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe të udhëzimit nr. 22, datë 10.7.2013, të ministrit të Financave, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për trajtimin dhe nënshkrimin e urdhrave për shërbimet jashtë vendit, për punonjësit e aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të institucioneve të varësisë, Sekretarit të Përgjithshëm.
 2. Delegimi i kompetencave do të jetë në fuqi deri në një urdhër të dytë.
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, nëpunësit e aparatit dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
 4. Urdhri nr. 51, datë 14.2.2022, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj